



## Manuali i Përdorimit të Legjislacionit Komunitar



Ministria e Integritimit European





Ministria e Integritit European

# **Manuali i Përdorimit të Legjislacionit Komunitar**

Përgatitur nga:

Qendra e Informacionit dhe Dokumentacionit European,  
Ministria e Integritimit European

Adresa:

Biv."Dëshmorët e Kombit" Pallati i Kongreseve

Tirana, Albania.

Tel./Fax.: +355 4 264 833

E-mail: [eidc@mie.gov.al](mailto:eidc@mie.gov.al)

Website: [www.mie.gov.al](http://www.mie.gov.al)

Ky botim u mundësua me mbështetjen financiare të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) në kuadër të Projektit të GTZ-së "Mbështetje për Integrimin European".

## **MANUAL PER PERDORIMIN E LEGJISLACIONIT KOMUNITAR**

Institucionet e Komuniteteve Europiane, publikojne rregullisht *Permbledhjen e Legjislacionit Komunitar ne fuqi* (Dy here ne vit). Kjo permbledhje perfshin te gjitha legjislacionin e botuar ne Fletoret Zyrtare te Komuniteteve Europiane (OJ) sipas periudhave kohore.

Kjo plotesohet ne baze te te dhenave te CELEX, sistemit te kompjuterizuar te dokumentacionit nderinstitucional per te drejten komunitare, e cila qe prej 1981-it, ka qene e hapur per publikun. Numrat e dhene ne keto indekse , ndihmojne perdoruesit qe me ane te CELEX-it te mund te gjejne tekset e plota te dokumentave qe ata duan si dhe te marrin detaje per ndryshimet qe mund t'i jene bere atyre akteve qe nga publikimi i indekseve.

Nisur nga dokumentacioni qe mbulon, Indeksi nuk perfshin vetem legjislacionin aktual komunitar, por dhe instrumenta te tjere qe pasqyrojne aktivitetet e Bashkimit Europian ( European Union, European Coal and Steel Community , European Economic Community , European Communities dhe EuroAtom) si instrumentat e politikes dhe vendimet e marra ne rastet individuale por qe kane nje interes me te pergjithshem.

Ne keto indekse perfshihen :

- **Marreshjet dhe konventat** e perfunduara nga Komitetet lidhur me marredheniet me jashte;
- **Legjislacioni detyrues dytesor** (rregullore, vendime, rekomandime dhe vendime te pergjithshme te KEQC, direktiva KEE/KE/ Euroatom) ne baze te Traktateve te themelimit te BE-se dhe te KE-se, me perjashtim te akteve administrative te perditshme;
- **Legjislacion shtese**, ne vecanti vendimet e perfaqesuesve te Qeverive te Shteteve Anetare qe marrin pjese ne takimet e Keshillit;
- Disa **akte jo detyruese**, por qe konsiderohen te rendesishme prej institucioneve;

## *Burimet e se drejtes komunitare*

### **1. Legjislacioni paresor**

- Traktatet qe krijojne Komunitetet
- Parime te pergjithshme te se drejtes

### **2. Marreveshjet nderkombetare te KE-se**

### **3. Legjislacioni dytesor**

- Rregulloret
- Direktivat/rekomandimet e Komunitetit Europian te Qymyrit dhe Celikut
- Vendime te pergjithshme dhe individuale

### **4. Parime te pergjithshme te te drejtes administrative**

### **5. Konventat ndermjet Shteteve Anetare**

## **1. TRAKTATET E THEMELIMIT TE KOMUNITETEVE EUROPIANE (EC)**

Traktatet e themelimit te Komuniteteve Europiane si dhe anekset dhe protokollat e tyre jane burimi kryesor i Legjislacionit te BE-se. Ketu hyjne:

- Traktatet themeluese te Bashkimit Europian:
  - Traktati i Komunitetit Europian te Qymyrit dhe Çelikut (Paris 1951),
  - Traktati i Komunitetit Ekonomik Europian (Rome, 1957),
  - Traktati i Bashkimit Europian (Maastricht, 1992)
- Traktatet qe ndryshojne Traktatet themeluese si:
  - Traktati i Bashkimit te Traktateve (1965),
  - Traktati i Buxhetit (1970,1975),
  - Akti Unik Europian (1986),
  - Traktati i Amsterdamit (1997),
  - Traktati i Nices (2001).

## **2. PARIME TE PERGJITHSHME TE SE DREJTES**

### ***Parimet e pergjithshme te se drejtes***

Te gjitha burimet e legjislacionit te permendura deri tani jane pjese e te drejtes se shkruar. Sikunder te gjitha sistemet e se drejtes, ekzistojne boshlleqe te cilat mbushen nga e drejta e pashkruar.

### ***Burime te se drejtes se pashkruar***

Burimet e te drejtes komunitare te pashkruar jane parimet e pergjithshme te se drejtes. Keto jane rregulla qe reflektojne konceptet elementare te se drejtes dhe drejtesise qe duhet te respektohen nga cdo sistem ligjor.

## **3. MARREVESHJET NDERKOMBETARE TE KE-SE**

Legjislacioni qe rrjedh prej marredhenieve me jashte te KE (ose te Vendeve Anetare – Member States) ku marredheniet e tyre me jashte, jane ne perputhje me ato te KE-se.

- ***Marreveshjet nderkombetare***

Ato jane nje burim i trete i legjislacionit komunitar dhe kane te bejne me rolin e KE ne nivel nderkombetar. Si nje nga pikat fokale te botes, Europa eshte e perfshire ne marredheniet ekonomike, sociale dhe politike me pjesen tjeter te botes. Per kete arsye, Komuniteti nenshkruan marreveshje me vende jo-anetare dhe me organizata te tjera nderkombetare. Kjo vjen nga traktatet dhe ne to parashikohet shtrirja e bashkepunimit ne fushen e tregtise ose industrise, fushen sociale, per marreveshje mbi tregtine ne produkte te vecanta.

Vlen te permendet se ekzistojne tre lloj marreveshjesh mes Komunitetit dhe vendeve jo-anetare.

- ***Marreveshjet e asociimit***

Asociimi shkon tej rregullimeve te thjeshta te tregtise dhe perfshin nje bashkepunim me te ngushte ekonomik sikunder dhe nje shkalle te gjere te asistences financiare te BE-se per vendin ne fjale {neni 310, (ish-neni 238) KE}. Megjithate mund te flitet per nje dallim mes tre llojeve te ndryshme te marreveshjes se asociimit.

*Marreveshje qe permbajne marredhenie te vecanta ndermjet disa Shteteve Anetare dhe Shteteve jo-anetare.*

*Marreveshje per pergatitjen per anetaresim ne Komunitet ose per krijimin e nje bashkimi doganor.*

*Marreveshje mbi Zonen Ekonomike Europiane(EEA)*

- ***Marreveshjet e Bashkepunimit***

Keto marreveshje nuk ndryshojne shume nga marreveshjet e asociimit dhe konsistojne ne bashkepunim intensiv ekonomik. Komuniteti ka marreveshje te tilla me shtetet e Maghreb (Maroku, Algjeria dhe Tunizia), te shteteve te Mashreq (Egjipti, Jordania, Libani dhe Siria) dhe Izraelin (neni 300 KE).

- ***Marreveshjet e tregtise***

Komuniteti ka nje numer te konsiderueshem marreveshjesh tregtie me nje sere vendesh jo-anetare sikunder dhe me nje sere organizatash nderkombetare lidhur me tarifat dhe politikat e tregtise. Marreveshjet me te rendesishme te tregtise jane: Marreveshjet e krijimit te OBT dhe marreveshjet shumepaleshe te tregtise qe rrjedhin prej saj, duke perfshire ne vecanti Marreveshjen e Pergjithshme mbi Tarifat dhe Tregtine (GATT1994), Kodi Anti-Dumping, Marreveshja mbi Aspektin tregtar te te Drejtave te Pronesise Intelektuale (TRIPS) si dhe Rregullat dhe Procedurat per Zgjidhjen e Mosmarrveshjeve.

- ***Marreveshjet midis Shteteve Anetare***

Marreveshjet e ketij lloji mund te perfundohen duke percaktuar ceshtjet qe lidhen ngushte me aktivitetet e Komunitetit, por nje e drejte e tille nuk iu eshte transferuar Shteteve Anetare; gjithashtu ekzistojne dhe marreveshje nderkombetare ne shkalle te gjere "full-scale" (marreveshje dhe konventa) midis Shteteve Anetare te cilat synojne te kalojne pengesat territoriale duke hartuar ligje te cilat zbatohen ne te gjitha Komunitetin (neni 293 i Traktatit te Bashkimit European). Kjo pjese e legjislacionit eshte e rendesishme kryesisht ne fushen e te drejtes nderkombetare private. Marreveshjet perfshijne: Konventat mbi juridiksionin dhe zbatimin e drejtesise ne ceshtjet civile dhe tregtare (1968), Konventa per njohjen shumepaleshe te kompanive dhe personave juridike (1968), Konventen per eliminimin e taksimit te dyfishte ne lidhje me rregullimin e transfertave te perfitimit midis sipermarrjeve (1990), Konventa per ligjin e zbatueshme tek detyrimet kontraktuale (1980) dhe Konventa per Patenten e Komunitetit (1989).



## 4. LEGJISLACIONI DYTESOR

- **Rregulloret**

Rregulloret jane norma te nxjerra nga nje institucion nderkombetar (KE) Rregulloret jane te detyrueshme per te gjitha Vendet Anetare dhe jane direkt te zbatueshme (Neni 249) brenda ketyre vendeve. Ato duhet te publikohen ne Fletoren Zyrtare dhe hyjne ne zbatim ne daten qe eshte percaktuar ne rregulloret e vecanta ose ne rast se kjo nuk percaktohet, hyn ne fuqi ditën e 20 pas publikimit.

Rregulloret jane te zbaueshme ne mase te gjere ne Vendet Anetare. Gjykata Europiane e Drejtësisë ka percaktuar se rregulloret masa normative abstrakte te cilat nuk i drejtohen nje personi te caktuar. Ne kete menyre rregulloret jane te ngjashme me legjislacionin kombetar, primar ose sekondar.

- **Direktivat**

Ndryshojne nga rregulloret ne dy raste : Ato mund t'i drejtohen cdonjerit prej Vendeve Anetare pa iu drejtuar te gjithëve se bashku; megjithese jane detyruese, ato i lene Vendeve Anetare mundesi zgjedhje te formes dhe menyres se zbatimit.

Te gjitha direktivat duhet ti njoftohen personit te cilit i adresohen. Data e hyrjes ne fuqi e direktivave eshte e njejte si per rregulloret, 20 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

- **Vendimet**

Vendimet, ashtu sic percaktohet dhe ne Nenin 249 KE, jane te detyrueshme per ata te cileve iu drejtohen. Ato duhet t'iu njoftohen personave qe iu adresohen dhe hyjne ne fuqi kur keta persona jane njoftuar.

Vendimet e marra ne perputhje me Nenin 251 duhet te botohen ne Fletoren Zyrtare. Ato hyjne ne fuqi nga data e percaktuar ne te ose ne mungese te nje date te tille, 20 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

- **Rekomandimet dhe Opinionet**

Fletorja Zyrtare e KE –se (Official Journal) publikohet cdo dite ne 11 gjuhe. Ajo perbehet nga

**Serite L** – qe permbajne legjislacion

**Serite C** – qe permbajne akte pergatitore dhe njoftime

Gjithashtu ka dhe nje seksion elektronik te serive C te njohur si OJ CE dhe dokumentat e botuara aty jane vetem ne rruge elektronike.

**Serite S** – qe permbajne ofertat per tender. Keto jepen ne Supplementet e OJ.

- **Legjislacioni Shtese**

Ne kete kete pjese te legjislacionit hyjne vendimet e marra ne takimet e perfaqesuesve te Vendeve Anetare brenda Keshillit, Konventat nderkombetare te perfunduara mes Shteteve Anetare ne perputhje me nenet e Traktateve.

## SHPJEGIMET E KODEVE

Numrat e dokumentave

Shënohen me gërma të errëta ne rastet kur i referohen hyrjes ne fuqi per here te pare per nje akt dhe me ngjyre me te lehte kur i referohen CCC hyrjeve ne vazhdim. Numrat me germa te pjerreta i referohen akteve te ndryshuara, te cilat jepen pas aktit te ndryshuar.

Kodet e Germave te perdorura ne numrat e referencave te dokumentave qe tregojne formen ligjore te aktit

<b>A</b>	Marreveshje
<b>B</b>	Buxhet
<b>D</b>	Vendim
<b>K</b>	Rekomandim i ECSC ( European Coal and Steel Community)
<b>L</b>	Direktive
<b>R</b>	Rregullore
<b>S</b>	Vendim i pergjithshem i ECSC
<b>X</b>	Akte te tjera
<b>Y</b>	Akte te tjera (te publikuara ne serite “C” te GZ dhe me pas ne rend numerik te numrave seriale)

Kodet e Numrave te perdorura ne numrat e references se dokumentave, jane sipas seksionit dokumentar te CELEX

## TITULLI

Numri i dokumentit pasohet nga titulli i plote i aktit ligjor.

### Referenca e Publikimit

Titulli i aktit pasohet nga Referenca e publikimit, pergjithesisht Fletore Zyrtare e KE-se (OJ). Fletoret Zyrtare publikohen ne 20 gjuhete e shteteve anetare te Bashkimit European. Fletoret te perfshira ne serite C jane pjeserisht te publikuara ne rruge elektronike.

Referenca e publikimit konsiston ne :

- Numrin e FZ pasuar ne rastet e legjislacionit pas 1968 ( kur FZ ishte ndare ne “L” dhe “C”)
- Data e publikimit
- Numri i faqes

P.sh. OJ L 253 11.10.1993 p.1 interpretohet ne kete menyre:

*OJ – Fletore Zyrtare e Komuniteteve Europiane*

*L 253 – Serite L, Nr. 253*

*11.10.1993 – Data e Publikimit*

*p.1 – Faqja e FZ (faqja ku fillon teksti i aktit)*

### Numri i Dokumentit

Numri i Dokumentit i shenuar me te zeze siper titullit te aktit , konsiston ne nje kombinim te numrave dhe germave, pozicioni i te cilave ka nje kuptim te vecante.

Psh 3 1993 R 2454 interpretohet ne kete menyre:

*3- Seksioni i dokumentacionit ne CELEX ( sektori 3 = legjislacion dytesor) tregon sektorin ne sistemin e CELEX nen te cilin klasifikohet.*

*1993 - Viti i publikimit ose adaptimit te aktit ligjor*

*R - Forma ligjore ( R = Rregullore) Kjo zakonisht eshte ne pozicionin e gjashte*

*2454 - Numri serial ose numer tjeter i identifikimit te aktit ligjor*

***(Pra rregullore nr. 2454 te vitit ne fjale)***

## TEKSTET E KONSOLIDUARA – CONSOLIDATED TEXTS

Permbajne ndryshimet dhe ndryshimet ne dokumentat jo zyrtare. Keto tekste nuk kane vlere ligjore. Per kete qellim I duhet drejtuar Fletoreve Zyrtare.

## LEGJISLACIONI NE PERGATITJE - LEGISLATION IN PREPARATION

Perfshin te gjitha dokumentet qe I korrespondojne stadeve te para te procesit legjislativ dhe atij buxhetor. Per kete arsye perfshin:

- Propozimet legjislative te Komisionit qe publikohen ne serite COM dhe SEC si dhe ne serite C te Official Journal.
- Iniciativat legjislative dhe buxhetore te Parlamentit European
- Opinionet e Komitetit Ekonomik dhe Social dhe te Komitetit te Rajoneve
- Opinione dhe raporte te Gjykates se Llogarive
- Opinione te Bankes Qendrore Europiane

Consolidated Legislation - Permban legjislacionin ne fuqi, pra se bashku me te gjitha ndryshimet qe ka pesuar ky legjislacion(pra permban legjislacionin baze se bashku me ndryshimet.

Community Legislation in force – Permban legjislacionin ne fuqi

## PYETJET PARLAMENTARE

Anetaret e Parlamentit European i kerkojne Komisionit dhe Keshillit European:

- pyetje te shkruara (te shoqeruara me nje kerkese per nje pergjigje te shkruar te publikuar ne Fletoren Zyrtare);
- pyetje gojore (keto pyetje behen gjate sesionit dhe publikohen ne Debatet e Parlamentit European;
- pyetjet qe behen ne nje kohe te akorduar posacerisht per pyetje gjate nje Sesioni Parlamentar. Keto pyetje publikohen ne Fletoren Zyrtare

## KAZUSET

Ketu perfshihen:

- Vendimet e Gjykates se Drejtesise te Komunitetit European;
- Vendimet e Gjykates se Shkalles se Pare

- Opinionet e Gjykates se Drejtesise
- Opinionet e Avokateve te Pergjithshem

## DOKUMENTAT NE INTERES TE PUBLIKUT

Keto jane dokumenta ne te cilat Komisioni European shpreh nje opinion mbi nje pyetje ne interesin e pergjithshem te Komunitetit. Keto dokumenta publikohen si dokumenta COM. Ketu perfshihen:

- Librat e bardhe (propozime per veprimtarine e Komunitetit ne nje fushe te caktuar te publikuara nga Komisioni European).
- Komunikatat (keto dokumenta te cilat nuk kane pasoja ligjore, nxirren nga Komisioni per Institucionet e tjera Europiane. Keto dokumenta parashikojne programe dhe politika te reja).
- Raportet (keto dokumenta publikohen nga Komuniteti dhe lidhen me zbatimin e masave dhe politikave te Komunitetit).
- Librat e Gjelbert (keto dokumenta publikohen nga Komisioni dhe kane per qellim te nxisin konsultimet ne nivel komunitar per nje ceshtje te caktuar, si psh. telekomunikacionet, bashkepunimi ne fushen e drejtesise etj).
- Dokumentat me te cilat punon Komisioni (keto dokumenta kane per qellim te stimulojne debatin ne nje fushe te caktuar te interesit publik).

